NOTES ON ALBANIA EDICIONI 4

NË NEW JERSEY – USA – 14 JANAR 2025

Përgatitur nga Adem Belliu:

Albanian Culture, New York

“Notes on Albania “ edicioni i 4, një event shumëdimensional i iniciuar dhe organizuar nga diplomati Mal Berisha, mblodhi më 9 janar 2025, në një studio arti në Newark të New Jersey-it, mbi njëqind shqiptaro-amerikanë, aktivistë të komunitetit, personalitete të spikatura, artistë dhe artdashës, në një mbrëmje krejt të veçantë historike e kulturore, ku në qendër ishte promovimi i studimit “Malet e Gjigantëve” me autor antropologun amerikan Dr. Carleton Coon, përkthyer dhe punuar në shqip nga ambasador Mal Berisha.

“Notes on Albania 4”, sipas organizatorëve të këtij eventi (Berisha & Familja), lidhet ngushtësisht me emrin dhe veprën e gazetares amerikane Rose Wilder Lane, e cila në vitin 1920 jetoi në Tiranë dhe u dashurua pas Shqipërisë, së cilës i kushtoi një libër me kujtime *“Notes on Albania”*. Ky fakt domethënës u bë motiv, por edhe objekt i një ngjarjeje kaq të bukur artistike, historike dhe kulturore, që ambasador Mal Berisha e nisi në Londër, në vitet kur shërbeu si ambasador në Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën e Veriut.

Tri edicionet e para të *Notes on Albania* sollën tingujt e perlave të muzikës shqiptare nëpër botë: Ermonela Jaho dhe Arlinda Morava (edicioni i parë), Inva Mula dhe Genc Tukiçi (edicioni i dytë). Bashkim Ahmeti – Izano, me ngjyrat autentike të penelit të tij, dhe Sir Noel Malcolm, me veprën *"Kosova: një histori e shkurtër"*, u kulmuan në edicionin e tretë.
Dhe natyrshëm, edicioni i katërt i *Notes on Albania* do të duhej të vinte në vendin e origjinës – Amerikë, në vendin ku, që prej vitit 1882, kur shqiptari i parë u vendos këtu, ky komunitet për fat të mirë është rritur dhe vijon të rritet edhe kulturarisht.

Mbrëmja nisi me analiza dhe reflektime të detajuara rreth studimit *"Malet e Gjigantëve"*, ku ra në sy vëzhgimi i thellë dhe shkencor i Doktor Sali Berishës, i cili u prit ngrohtë dhe u duartrokit gjatë nga të pranishmit. Ata ndoqën me vëmendje Doktorin e Politikës, i cili në vitin 1991, në krah të James Baker, rihapi marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Amerikës, dhe më vonë, në vitin 2007, krah George W. Bush, do ta demonstronte fuqishëm këtë partneritet jetik mes dy vendeve. Kjo u bë përmes një lidhjeje në Skype.

Thirrja e tij për vitalizimin e rolit të Diasporës në proceset zgjedhore në Shqipëri e bëri të domosdoshëm shtjellimin teknik dhe teorik të zotit Zekeria Picari, i cili shpjegoi platformën më të re *“Diaspora për Shqipërinë”*, përmes së cilës shqiptarët emigrantë mund të votojnë.
Zonja Florida Hoxha shtjelloi në anglisht veçantitë antropologjike të gegëve të Shqipërisë së Veriut sipas Coon.Si na kanë parë të huajt? “Malet e gjigandëve “ është një nga rastet ku kjo pyetje merr shpjegim shkencor, social, kulturor, historik.

Studiuesi dhe diplomati Mal Berisha, i cili tërë veprën e tij ia ka kushtuar pikërisht këtij fenomeni, kujtojmë këtu përkthimin dhe studimin e plotë *“The National Geographic Magazine”*, veprën *“Vepra e jashtëzakonshme e Charles Telford Ericksonit për shqiptarët dhe për Shqipërinë”*, librin *“Herman Bernstein, Ambasador i pushtetit të butë”*, si dhe *“Realitete Shqiptaro-Britanike”*. Përmes hulumtimeve e studimeve të thelluara, ai nxjerr nga pluhuri i kohës dhe harresa vlera të harruara, të injoruara e të mohuara,

të shikuara nga fokusi i amerikanëve mendjendritur të kohës.

Ky edicion i katërt i *“Notes on Albania”* mori dhe solli shkëlqim nga ngjarja më e bukur kulturore e fundvitit: pranimi në UNESCO i Kërcimit të Tropojës. I konsideruar si monumental, si vetë kërcimi, ashtu edhe vlerësimi për të, bëri që studioja ku u zhvillua eventi të merrte, për disa minuta, ngjyrat, ritmet, dinamizmin dhe vitalitetin e këtyre valleve prej shtojzavallesh, që u shpalosën fillimisht në ekran e më pas “live” nga grupi **Rozafati**.

E kush nuk i njeh ato ritme, kush shqiptar, por edhe i huaj, nuk i ka dëgjuar ato? Por askush, si Angjelina Nikaj, nuk do të mundej të flasë e të shprehë gëzimin për këtë njohje ndërkombëtare të kësaj pasurie e trashëgimie. Si koreografe dhe profesore, si artiste dhe valltare, zonja Angjelina Nikaj shpalosi tërë diapazonin e njohjes mbi historikun, teknikat, ritmet dhe personalitetet që i dhanë jetë e pavdekësi Kërcimit të Tropojës.

Tingujt e Kërcimit të Tropojës u interpretuan në piano nga një i ri shqiptaro-amerikan, Lourian Saraçi, i cili luajti mjeshtërisht në piano *“Baladë nr. 3”* të Frédéric Chopin.

Mbrëmja e ngrohtë, në një natë të ftohtë të 9 janarit, u mbështet dhe u përshëndet nga personalitete si Fadil Berisha, simbol i promovimit të artit dhe të së bukurës në përgjithësi; zoti Harry Bajraktari, aktivist dhe mbrojtës i palodhur i çështjeve kombëtare; zoti Agim Rexhaj, president nderi i Federatës Panshqiptare “Vatra”; analisti dhe aktivisti Agim Aliçkaj; zonja Violeta Berisha, kryetare e Bashkisë Fairview.

Notes on Albania 4 u mbyll mes trokitjes së gotave, shtrëngimeve të duarve, bisedave të ngrohta, që u bënë edhe më të ngrohta nga bujaria e “Sihana Bistro”, me drejtues Kreshnik Berisha, sponsor i përgjithshëm i këtij eventi, i cili u ndoq edhe nga media shqiptaro-amerikane **Albanian Culture TV, New York**.

Kur do të jetë edicioni i pestë?!


Përkthimi, botimi dhe promovimi i këtij libri janë realizuar nën kujdesin dhe mbështetjen financiare të z.Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA GROUP AL-KS-MKV.
CARLETON S. COON
MUZEU PEABODY, UNIVERSITETI HARVARD
Cambridge, Massachusetts, USA
CARLETON S. COON
MALET E GJIGANTËVE
Carleton S. Coon
Nëse antropologjia është studimi i asaj që na bëri neve njerëz, historia është gjaku jetësor i etnografisë ndërsa historianët janë fiziologët e shoqërive. Detyra e etnografit është të përshkruajë kulturën, të tregojë ku jeton një popull i caktuar, sa vetë e përbejnë atë numërikisht, çfarë mjetesh pune dhe veglash ka përdorur për t'u përshtatur me natyrën, çfarë organizimi familjar ka pasur, çfarë institucionesh të tjera ka mundur të formojë, për tregti apo për qeverisje, si i ka ndërtuar marrëdhëniet me popujt e tjerë dhe si i ka plotësuar nevojat e veta jetësore dhe rituale?
Në këtë rast, problemi ynë është të zbulojmë gjithçka që mundemi për origjinën e popullit Gegë, vijueshmërinë gjenetike të atyre banorëve që jetojnë brenda fortesës së tyre malore, kohën kur janë vendosur aty, veçoritë e origjinës dhe karakteristikat fizike të çdo të huaji, që mund të ketë shkelur dhe perzier gjakun me ta, në ato troje.
MALET E GJIGANTËVE
STUDIM RACOR DHE KULTUROR KUSHTUAR GEGËVE TË SHQIPËRISË SË VERIUT
Çmimi 1200 lekë
Përktheu
Mal BERISHA

Promovim i librit:
"MALET E GJIGANTËVE"
Shkruar nga Prof. Dr.
CARLETON S. COON,
Përkthyer nga:
Mal BERISHA
Newark, 9 Janar 2025